Mentor Mazrekaj: Dua te mos largohem nga Partizani

nga AlbaniaSoccer
E martë, 12 Nentor 2013 22:11

Mentor Mazrekaj nje nga lojtaret me te mire tek Partizani por i huazuar nga Prishtina ka folur per te ardhmen e tij. Mesfushori i talentuar ka fituar zemren e te kuqve dhe vete ndihet mjaft mire ne Tirane e nuk deshiron te largohet. “Gjithçka do te vendoset ne janar kur me skadon kontrata me Partizanin, pasi per momentin nuk kam nje pergjigje per kete. Mbetet te pres dhe te shoh se çfare do te ndodh pas bisedimeve mes klubeve te Prishtines dhe Partizanit. Deshira ime eshte qe te qendroj te Partizani, te pakten deri ne fund te ketij sezoni pasi dua qe te jem pjese e ketij projekti serioz. Shpresoj qe te arrijme objektivat dhe ta dergojme Partizanin aty ku e ka vendin. Marredheniet me tifozet kane qene te shkelqyera qe ne momentin e pare qe kam ardhur tek Partizani. Jam shume i kenaqur me perkrahjen qe i japin skuadres duke u bere lojtari i 12-te i skuadres.”, ka deklaruar Mentor Mazrekaj.